

OGERTA MANASTIRLIU



Datëlindja: 31.12.1978

Vendlindja: Tiranë

Email: Ogerta.Manastirliu@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Kimi. Ka titullin Doktor i Shkencave në “Kimi Analitike dhe Mjedis”. Në vitin 2004 ka nisur karrierën profesionale në Bashkinë e Tiranës, fillimisht në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve. Gjatë viteve 2005-2011, ka drejtuar Drejtorinë e Strehimit dhe Shërbimit Social, Bashkia Tiranë.

Në periudhën 2011-2013, ajo është angazhuar si eksperte për menaxhimin dhe koordinimin e politikave sociale dhe burimeve njerëzore për organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si UNFPA, Friedrich Ebert Stiftung etj. Në periudhën shtator 2013 – mars 2017, znj. Manastirliu ka drejtuar Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë.

Që prej vitit 2017 e në vijim ka mbajtur pozicionin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.